REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA | REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
AGENCIJA ZA SPREČAVANJE KORUPCIJE
AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION

# AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT

## PLANI VJETOR I PERFORMANCËS PËR VITIN 2026

**Prishtinë, nëntor 2025**

# Përmbajtja

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE ..... 3

DETYRAT, PËRGJEGJËSITË DHE STRUKTURA EKZISTUESE E AGJENCISË ..... 4

KORNIZA LIGJORE E AGJENCISË ..... 5

PROCESI I HARTIMIT TË PLANIT TË PUNËS - METODOLOGJIA ..... 6

OBJEKTIVA 1. RI-SHIKIMI DHE PLOTËSIMI I LEGJISLACIONIT SEKONDAR ..... 7

OBJEKTIVA 2. FUQIZIMI, KOORDINIMI DHE NGRITJA E KAPACITETEVE PROFESIONALE TË AGJENCISË SIPAS MANDATIT LIGJOR ..... 9

OBJEKTIVA 3. AVANCIMI I SISTEMEVE ELEKTRONIKE DHE DIGJITALIZIMI I PROCESEVE DHE TË DHËNAVE ..... 11

OBJEKTIVA 4. PËRMIRËSIMI I KOMUNIKIMIT ME PARTNERË DHE AKTERË TË JASHTËM DHE RRITJA E AKTIVITETEVE VETDIJESUESE PER PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT ..... 12

OBJEKTIVA 5. PËRMBUSHJA E MANDATIT TE AGJENCISË PERMES AKTIVITETEVE TE RREGULLTA ..... 15

5.1 ..... 15

DEKLARIMI, REGJISTRIMI DHE KONTROLLI I PASURISË SË ZYRTARËVE TË LARTË PUBLIK ..... 15

5.2 ..... 16

SHQYRTIMI I RASTEVE TË KONFLIKTIT TË INTERESIT ..... 16

5.3 ..... 17

SINJALIZIMI ..... 17

5.4 ..... 17

MONITORIMI, VLERËSIMI DHE ANALIZA ..... 17

OBJEKTIVA 6. SIGURIMI I BURIMEVE ADMINISTRATIVE, FINANCIARE DHE LOGJISTIKE PËR ZBATIMIN EFIKAS TË MANDATIT TË AGJENCISË ..... 18



I nderuar, **Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës**,

Të nderuar Kryetar dhe anëtarë të Komisionit Mbikëqyrës të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit,

Në pajtim me mandatin ligjor të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit (APK) dhe në përputhje me kërkesat për planifikim dhe raportim ndaj Kuvendit të Republikës së Kosovës, kam nderin dhe përgjegjësinë që t'ju paraqes Planin e Performancës së Agjencisë për vitin 2026.
Ky dokument përfaqëson angazhimin e Agjencisë për forcimin e integritetit institucional, zbatimin efikas të legjislacionit kundër korrupsionit dhe promovimin e transparencës e llogaridhënies në administratën publike.

Plani i Performancës për vitin 2026 mbështetet në tri prioritete strategjike, të cilat konkretizohen përmes gjashtë objektivave kryesorë:

**Forcimi i mekanizmave ligjorë dhe institucionalë për parandalimin e korrupsionit**
Agjencia do të vazhdojë zbatimin dhe monitorimin e ligjeve që ndërlidhen me parandalimin e konfliktit të interesit, deklarimin e pasurisë dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. Do të ndërmerren veprime për forcimin e kapaciteteve të monitorimit dhe analizës, si dhe për përmirësimin e kornizës ligjore, aty ku nevojitet, në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira evropiane dhe ndërkombëtare.

**Digjitalizimi dhe modernizimi i proceseve institucionale**
Transformimi digjital mbetet një ndër prioritetet kyçe të Agjencisë. Për vitin 2026 synohet avancimi i platformave elektronike për deklarimin e pasurisë, zhvillimi i aplikacioneve mobile për qasje më të lehtë të zyrtarëve publikë, si dhe digjitalizimi i arkivës dhe protokollit. Gjithashtu, do të promovohet publikimi i të dhënave në formatin Open Data, duke siguruar një nivel më të lartë të transparencës dhe sigurisë së informacionit.

**Rritja e vetëdijes publike dhe bashkëpunimit ndërinstitucional në fushën e parandalimit të korrupsionit**
Përmes fushatave publike, programeve edukative dhe bashkëpunimit me institucionet publike e organizatat e shoqërisë civile, Agjencia do të punojë për ndërtimin e një kulture të integritetit në sektorin publik dhe privat. Do të promovohen vlera të etikës, përgjegjësisë dhe llogaridhënies si parime themelore të mirëqeverisjes.

Realizimi i këtij plani kërkon bashkëpunim të ngushtë ndërinstitucional dhe mbështetjen tuaj të vazhdueshme. Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit mbetet e përkushtuar ndaj transparencës, profesionalizmit dhe raportimit të rregullt për progresin dhe rezultatet e arritura.

Ju falënderoj për besimin, përkrahjen dhe bashkëpunimin tuaj të vazhdueshëm.
Presim me interes komentet dhe rekomandimet tuaja për përmirësimin e mëtejshëm të punës sonë.

Me respekt,

**Yll Buleshkaj, Drejtor i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit**

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Plani i performancës së Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit për vitin 2026 reflekton punën dhe përpjekjet e vazhdueshme të Agjencisë drejtë misionit të saj në parandalimin dhe luftimin e praktikave korruptive sipas legjislacionit në fuqi, përmes rritjes së integritetit institucional si dhe transparencës në sektorin publik.

Plani i Performancës për vitin 2026, fokusohet në objektiva konkrete, të mbështetura me aktivitete të matshme dhe masa strategjike, me të cilat synohet rritja e performancës dhe efikasitetit të punës së Agjencisë. Rishikimi dhe plotësimi i legjislacionit sekondar, fuqizimi i kapaciteteve profesionale dhe avancimi i sistemeve elektronike për menaxhimin e të dhënave janë disa nga objektivat kyçe të Agjencisë për vitin 2026, përfshirë edhe aktivitetet e rregullta të cilat janë pjesë e vazhdueshme e planit të punës së Agjencisë.

Në përputhje me ligjet në fuqi, Agjencia synon të analizojë dhe përditësojë dokumentet e saj për t'u siguruar që janë praktikisht efektive dhe ligjërisht të qëndrueshme. Një prioritet i lartë i saj është edhe fuqizimi i burimeve njerëzore përmes trajnimit dhe profilizimit të stafit të Agjencisë, për përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësive.

Gjithashtu, Agjencia planifikon të avancojë infrastrukturën teknologjike duke ri-dizajnuar sistemet elektronike të menaxhimit të deklarimit të pasurisë, verifikimit, menaxhimit të konflikteve të interesit, dhe digjitalizimit të të dhënave historike.

Ndërsa, për të përmirësuar edukimin dhe informimin e publikut si dhe për të fuqizuar partneritetet, Agjencia synon të zbatoj fushata edukative për promovimin e integritetit dhe kundër korrupsionin, duke angazhuar publikun, të rinjtë dhe zyrtarët publik përmes trajnimeve dhe publikimeve.

Në mbështetje të mandatit të saj, Agjencia ka identifikuar 82 aktivitete kyçe për vitin 2026, duke përfshirë edhe aktivitete të rregullta që synojnë përmbushjen efektive të përgjegjësive të saj ligjore dhe sigurimin e burimeve administrative, financiare dhe logjistike të nevojshme për të mbështetur funksionimin e saj efektiv.

## OBJEKTIVAT KRYESORE

1. Ri-shikimi dhe plotësimi i legjislacionit sekondar;
2. Fuqizimi, koordinimi dhe ngritja e kapaciteteve profesionale të Agjencisë sipas mandatit ligjor;
3. Avancimi i sistemeve elektronike të Agjencisë dhe digjitalizimi i proceseve dhe të dhënave;
4. Përmirësimi i komunikimit me partnerë dhe akterë të jashtëm, si dhe rritja e aktiviteteve vetdijesuese për parandalimin e korrupsionit;
5. Përmbushja e mandatit të Agjencisë përmes aktiviteteve të rregullta; dhe
6. Sigurimi i burimeve administrative, financiare dhe logjistike për zbatimin efikas të mandatit të Agjencisë;

Agjencia planifikon ri-shikimin dhe plotësimin e legjislacionit sekondar, me qëllim të zbatimit më efikas dhe të drejtë të tyre.

Sipas legjislacionit në fuqi, Agjencia gjatë vitit 2025 ka hartuar dhe miratuar akte nënligjore, rregullore, udhëzues, dhe dokumente tjera të rëndësishme, me qëllim të funksionalizimit dhe plotësimit të kornizës ligjore si rezultat i nevojave dhe kërkesave për hartimin dhe plotësimin e legjislacionit sekondar. Për vitin 2026, Agjencia synon rishikimin dhe plotësimin në vazhdim të legjislacionit sekondar, me qëllim të zbatimit më efikas dhe të drejtë të tij. Këto dokumente do të analizohen, vlerësohen dhe do të rishikohen nga stafi i Agjencisë, me qëllim të sigurimit të zbatimit efektiv dhe përshtatjes së tyre konform nevojave të paraqitura.

Përmes analizimit dhe rishikimit të nevojave për plotësimin e legjislacionit sekondar ekzistues si dhe plotësimit të kuadrit ligjor, synohet rritja e efikasitetit në punë si dhe qëndrueshmëria funksionale në zbatimin e tyre.

Fuqizimi i kapaciteteve njerëzore vazhdon të mbetet një nga objektivat kyçe si dhe nga prioritetet e Agjencisë me qëllim të përmbushjes së plotë të mandatit dhe fushë-veprimtarisë së Agjencisë konform kornizës ligjore në fuqi.

Stafi ekzistues i Agjencisë, planifikohet që të mentorohet përmes shkëmbimit të përvojave kudo që është e aplikueshme dhe të trajnohet me qëllim të aftësimit për të zbatuar në plotni mandatin. Agjencia harton dhe zbaton planin e vet për ngritje të kapacitetit bazuar në procesin e vetëvlerësimit.

Agjencia synon që ta vazhdoj trendin pozitiv të avancimit të sistemeve elektronike dhe infrastrukturës së teknologjisë informative. Gjatë vitit 2026, do të bëjë zhvillimin e aplikacionit mobil për platformën Raporto Korrupsionin, duke përfshi modulet: sinjalizim, konflikt i interesit, deklarim i pasurisë dhe deklarim i dhuratave. Duke rritur sigurinë e të dhënave dhe sistemeve do të bëjmë ndërtimin e infrastrukturës së re fizike të rrjetit kompjuterik të Agjencisë dhe sigurimin e baterive dhe investimeve harduerike me kapacitete të reja për qendrën e të dhënave elektronike. Gjatë vitit 2026, do të bëhet digjitalizimi i protokollit dhe i dokumenteve të arkivës fizike të Agjencisë që nga themelimi i saj. Në aspektin e automatizimit të proceseve të punës do të bëjmë analizimin e sistemeve elektronike të reja DMSA dhe DMSA-CMS, për të identifikuar proceset dhe modulet në të cilat mund të aplikojmë Inteligjencë Artificiale.

Agjencia poashtu synon të avancojë komunikimin dhe të thellojë ndërgjegjësimin e zyrtarëve publik dhe qytetarëve për vlerat e integritetit, transparencës, llogaridhënies dhe kundër-korrupsionit, duke përdorur një qasje të gjerë edukative dhe bashkëpunime me partnerë të jashtëm. Aktivitetet kryesore janë të strukturuara për të përmirësuar transparencën dhe për të fuqizuar kapacitetet e institucioneve publike dhe komuniteteve, përfshirë nxënësit, studentët, zyrtarët publik dhe organizatat joqeveritare. Strategjitë kryesore përfshijnë angazhimin e drejtpërdrejtë me komunitetet përmes takimeve, fushatave të mediave sociale, trajnimeve specifike dhe publikimeve informuese.

Objektivat Strategjike të Planit të Komunikimit të APK fokusohen:

**Rritja e ndërgjegjësimit publik** përmes fushatave të qëndrueshme dhe materialeve të strukturuara edukative.

**Angazhimi i të rinjve dhe qytetarëve** përmes aktiviteteve të targetuara që nxisin pjesëmarrjen dhe promovojnë integritetin si vlerë shoqërore.

**Fuqizimi i kapaciteteve të institucioneve publike** për zbatimin e ligjit dhe për të mbështetur transparencën në sektorin publik.

**Ndërtimi i besimit të publikut në APK** si një agjenci e përkushtuar ndaj etikës dhe transparencës në Kosovë.

Nëpërmjet këtij plani, APK synon jo vetëm të informojë, por të krijojë një kulturë të qëndrueshme, ku integriteti dhe parandalimi i korrupsionit bëhen vlera të përbashkëta dhe të respektuara nga të gjitha institucionet dhe segmentet e shoqërisë.

Aktivitetet e rregullta të Agjencisë të cilat janë pjesë integruese e këtij plani, synojnë poashtu përmbushjen dhe kryerjen e detyrave dhe përgjegjësive të Agjencisë drejt parandalimit të korrupsionit. Në kuadër të kësaj objektive, janë planifikuar 29 aktivitete me të cilat Agjencia synon zbatimin e mandatit të saj në pajtim me kompetencat dhe përgjegjësitë ligjore.

Burimet e mjaftueshme administrative, financiare dhe logjistike, sigurojnë zbatimin efektiv të mandatit ligjor të Agjencisë. Kjo përfshin sigurimin e financimit të duhur, sigurimin e infrastrukturës së nevojshme dhe riorganizimin e proceseve për të mbështetur efikasitetin operacional. Këto burime garantojnë përmbushjen e përgjegjësive të Agjencisë si dhe qëllimet strategjike të saj, duke ofruar shërbime në mënyrë efektive në pajtim me kërkesat ligjore institucionale.

## DETYRAT, PËRGJEGJËSITË DHE STRUKTURA EKZISTUESE E AGJENCISË

Në bazë të Ligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Agjencia definohet si organ i pavarur dhe i specializuar në parandalimin e korrupsionit në Kosovë. Agjencia është themeluar në korrik të vitit 2006, ndërsa është funksionalizuar më 12 shkurt 2007.

Fushëveprimi i Agjencisë është i përqendruar në 8 grupe të funksioneve kryesore:

a) Funksionet që kanë të bëjnë me deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave;

b) Funksionet që ndërlidhen me parandalimin e konfliktit të interesit;

c) Funksionet që ndërlidhen me mbrojtjen e sinjalizuesve;

d) Funksionet që ndërlidhen me planet e integritetit;

e) Funksionet strategjike;

f) Funksionet për vlerësimin e rrezikut nga korrupsioni dhe vlerësimin e akteve ligjore kundër korrupsionit;

g) Funksionet që lidhen me raportim dhe statistika; dhe

h) Funksionet mbështetëse.

Agjencia, aktualisht ka të punësuar 58 zyrtarë.

Struktura organizative e Agjencisë është e ndarë në këto departamente dhe divizione:

**A. Departamenti për Vlerësim, Monitorim dhe Analiza** është përgjegjës për analizimin dhe vlerësimin e legjislacionit vendor në harmoni me parimet dhe standardet ndërkombëtare kundër korrupsion, sigurimin e monitorimit dhe analizimin pro aktiv të zbatimit të planeve të integritetit dhe strategjisë shtetërore kundër korrupsion. Ky Departament është i përbërë nga: 1. Divizioni për Integritet dhe Strategji, dhe 2. Divizioni për Analiza dhe Vlerësim kundër Korrupsion. Në kuadër të këtij Departamenti janë deleguar përgjegjësitë ligjore që ndërlidhen me hartimin e planeve të integritetit, vlerësimit të rrezikut nga korrupsioni dhe vlerësimi i akteve ligjore kundër korrupsionit.

**B. Departamenti për Parandalimin e Konfliktit të Interesit** është përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesit të zyrtarëve të lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik, merret me analizimin dhe trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit, ofron asistencë profesionale dhe këshilla sipas kërkesave nga zyrtarë publik dhe institucione tjera në fushën e parandalimit të konfliktit të interesit. Ky Departament është i përbërë nga: 1. Divizioni për Zgjidhjen e Konfliktit të Interesit, dhe 2. Divizioni për Këshillim dhe Raportim.

**C. Departamenti për Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave** është përgjegjës për mbikëqyrjen e pasurisë dhe mbikëqyrjen e dhuratave për zyrtarët e lartë dhe zyrtarët publik, si dhe trajtimin dhe mbikëqyrjen e pranimit dhe regjistrimin e dhuratave. Ky Departament është i përbërë nga: 1. Divizioni për Kontrollin dhe Verifikimin e Pasurisë,2. Divizioni për Inspektimin dhe Auditimin e Dhuratave, si dhe 3. Divizioni për Deklarimin e Pasurisë dhe Shqiptimin e Gjobave.

**D. Departamenti për Administratë dhe Shërbime të Përgjithshme** është përgjegjës për menaxhimin dhe përkujdesjen për burimet materiale, ofrimin e shërbimeve administrative efikase, e-shërbime dhe teknologji informative në mënyrë efektive. Ky Departament është i përbërë nga: 1. Divizioni për E-Shërbime dhe Sisteme, dhe 2. Divizioni për Shërbime të Përgjithshme.

**E. Divizioni për Buxhet dhe Financa** është përgjegjës për menaxhimin e buxhetit dhe shpenzimeve financiare si dhe siguron regjistrimin e pasurive të Agjencisë dhe përditësimin e këtyre regjistrave.

**F. Divizioni për Sinjalizim** është përgjegjës për sigurimin e funksionimit efikas të mekanizmit të sinjalizimit në sektorin publik, për kryerjen e hetimeve administrative dhe për ndërmarrjen e masave lidhur me mbrojtjen e sinjalizuesve, në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Sinjalizuesve. Po ashtu, sipas kërkesës, merr pjesë në përgatitjen e programeve të trajnimit për zyrtarët përgjegjës. Për qëllime vetëdijesimi, Divizioni organizon trajnime për këta zyrtarë dhe ndërmerr veprime për përgatitjen dhe publikimin e raportit vjetor të përgjithshëm mbi sinjalizimin, për vitin paraprak, deri më 31 mars të vitit vijues.

**G. Divizioni për Përfaqësim, Standardizim dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare** siguron përfaqësimin e Agjencisë pranë institucioneve të drejtësisë, standardizimin e shkresave dhe praktikave ligjore dhe administrative brenda Agjencisë, në pajtim me rregullat e brendshme dhe standardeve më të larta të profesionalizimit, si dhe avancimin e bashkëpunimit ndërkombëtar të Agjencisë, në aspekt të koordinimit dhe bashkëpunimit me organizata ndërkombëtare përmes shkëmbimit të përvojave nga fusha e parandalimit dhe luftimit të korrupsionit. Kujdeset për hartimin e planeve të ndryshme të Agjencisë si: Planit Vjetor të Performancës, Raportit Vjetor të Punës, Planit të Menaxhimit të Rrezikut, si dhe dokumenteve tjera me rëndësi sipas nevojave që mund të paraqiten në vazhdimësi. Ofron poashtu bashkëpunim dhe ndihmë profesionale për të gjitha njësitë organizative të Agjencisë.

**H. Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore** është përgjegjëse që të sigurojë menaxhim efektiv të burimeve njerëzore, përmes zhvillimit të procedurave dhe zhvillimeve që kontribuojnë në arritjen e qëllimeve të institucionit dhe punonjësve të Agjencisë.

**I. Informimi dhe Edukimi** është përgjegjës që të organizojë, koordinojë, menaxhojë dhe bashkërendojë aktivitetet lidhur me informimin e publikut dhe mediave përkitazi me punën, aktivitetet dhe veprimtarinë e Agjencisë.

**J. Prokurimi** është përgjegjës për menaxhimin e aktiviteteve të prokurimit dhe ka për qëllim të siguroj mënyrën më efikase, transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve të Autoritetit Kontraktues, duke dhënë kontributin për realizimin e objektivave të Agjencisë.

## KORNIZA LIGJORE E AGJENCISË

Aktualisht, Agjencia është e mandatuar për zbatimin e kornizës ligjore kundër korrupsion, si në vijim:

I. Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit;
II. Ligjit Nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave;
III. Ligji Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik;
IV. Ligji Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve.

Përveç zbatimit të kornizës ligjore si më lartë, Agjencia ushtron detyrat dhe përgjegjësitë e saj, konform legjislacionit tjetër relevant në fuqi si: Kodin Nr. 074 Penal të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit, si dhe ligjet tjera me të cilat Agjencia plotëson dhe përmbush mandatin e saj ligjor.

Ndërsa, punën e saj operative, Agjencia e realizon përmes Rregulloreve si në vijim:

I. Rregullorja nr. 03/2023 për Procedurat për Hetimet Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit;
II. Rregullorja Nr. 08/2024 e Punës së Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit;
III. Rregullorja Nr. 06/2024 për Shqiptimin e Gjobave si dhe Masave tjera Sanksionuese nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit;
IV. Rregullorja Nr. 05/2024 për Pranimin dhe Regjistrimin e Dhuratave nga Personat Zyrtarë;

## PROCESI I HARTIMIT TË PLANIT TË PUNËS METODOLOGJIA

Menaxhmenti i Agjencisë, ka mbajtur një seri takimesh pune ku të gjitha njësitë e Agjencisë kanë shqyrtuar kërkesat ligjore për Agjencinë, kanë raportuar për përmbushjen e Planit Vjetor të Performancës për vitin 2025, dhe kanë identifikuar objektivat dhe aktivitetet që do kontribuojnë në zbatimin e objektivave të identifikuara për vitin 2026.

Plani i performancës përmban tetëdhjetë e dy (82) aktivitete gjegjëse që do kontribuojnë në realizimin e objektivave dhe përmbushjen e mandatit të Agjencisë. Secili aktivitet ka titullin, përshkrimin e shkurtër të aktivitetit, njësinë përgjegjëse për zbatim, afatin kohor të zbatimit, duke përfshirë edhe periudhat kur do raportohet, treguesit e performancës dhe një vlerësim të përafërt të resurseve (kostos dhe burimit të buxhetit) kudo që mund të zbatohet.

Agjencia përgjatë vitit 2025 është përkrahur nga: a) Projekti i Këshillit të Evropës kundër Krimit Ekonomik në Kosovë (PECK III) dhe b) Projekti i UNDP për Mbështetje për Përpjekjet kundër Korrupsionit në Kosovë (SAEK III). Të dyja këto projekte kanë përfunduar në gjysmën e dytë të vitit 2025. Agjencia është përkrahur edhe nga shumë ambasada dhe misione diplomatike.

## OBJEKTIVA 1. RI-SHIKIMI DHE PLOTËSIMI LEGJISLACIONIT SEKONDAR

Në aspekt të ngritjes së efektivitetit dhe përmbushjes së mandatit të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit sipas legjislacionit në fuqi, gjatë vitit 2026 Agjencia synon rishikimin dhe plotësimin e legjislacionit sekondar, me qëllim të zbatimit më efikas dhe të drejtë të tij. Këto dokumente do të analizohen, vlerësohen dhe do të rishikohen nga stafi i Agjencisë, me qëllim të sigurimit të zbatimit efektiv dhe përshtatjes së tyre konform nevojave të paraqitura.

| **1** | **RI-SHIKIMI DHE PLOTËSIMI I LEGJISLACIONIT SEKONDAR** | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. | Aktiviteti | Përshkrimi i aktivitetit | Njësia përgjegjëse | Afati Kohor | | | | | | | | | | | | Raportimi | Treguesit e performancës | Vlerësimi i resurseve | |
| | | | | I | II | III | IV | V | VI | VII | VIII | IX | X | XI | XII | | | Kosto | Burimi |
| 1.1 | Finalizimi i Metodologjisë për monitorimin e zbatimit të Strategjisë dhe PV kundër korrupsion | Agjencia është përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të Strategjisë dhe PV kundër Korrupsionit pas miratimit nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Përmes Metodologjisë APK monitoron statusin e zbatimit të veprimeve që dalin nga këto dy dokumente politikash. Metodologjia e hartuar dhe finalizuar nga Grupi Punues, aprovohet nga Drejtori i Agjencisë | Zyra e Drejtorit dhe Grupi Punues | | | | | | | | | | | | | K1 | 1. Themelimi i Grupit Punues<br>2. Projekt Metodologjia e hartuar dhe finalizuar<br>3. Metodologjia e aprovuar | | Buxheti i APK dhe Donator |
| 1.2 | Hartimi i Rregullores për përdorimin dhe mbrojtjen e të dhënave elektronike të Agjencisë | Hartimi i Rregullores për përdorimin dhe mbrojtjen e të dhënave elektronike të Agjencisë, do të përcaktojë protokollet e përdorimit, qasjes dhe ruajtjes së të dhënave elektronike të Agjencisë | E-Shërbime dhe Sisteme, DPSMN | | | | | | | | | | | | | K1, K2 | 1. Themelimi i Grupit Punues<br>2. Projekt Rregullorja<br>3. Rregullorja e aprovuar | | Buxheti i APK-së donatorë |
| 1.3 | Hartimi i Rregullores së brendshme për komunikim dhe raportim | Hartimi i Rregullores së brendshme për komunikim dhe raportim do të përcaktojë rregullat kryesore te komunikimit, si dhe modelet e komunikimit | Zyra e Drejtorit/ DPSMN dhe Grupi Punues | | | | | | | | | | | | | K1 | 1. Themelimi i grupit Punues<br>2. Rregullorja e hartuar<br>3. Rregullorja e aprovuar | | Buxheti i APK-së |
| 1.4 | Hartimi i Rregullores për trajtimin dhe mbrojtjen e informacionit të klasifikuar | Hartimi i kësaj Rregulloreje do të përcaktojë procedurat dhe standardet e trajtimit dhe mbrojtjes së informacionit/dokumenteve të klasifikuara nga APK | Zyra e Drejtorit/ DPSMN | | | | | | | | | | | | | K1 | 1.Themelimi i Grupit Punues<br>2. Projekt Rregullorja<br>3. Rregullorja e miratuar | | APK |
| 1.5 | Hartimi i udhëzuesit për përdorim dhe standardizim të shkresave të Agjencisë | Hartimi i udhëzuesit, do të përcaktojë standardizimin e shkresave të Agjencisë dhe unifikimin e praktikave lidhur me formën, përmbajtjen dhe llojin e shkresave me të cilat | Zyra e Drejtorit/ DPSMN | | | | | | | | | | | | | K1, K2 | 1. Themelimi i Grupit Punues<br>2. Dokumenti i hartuar dhe i miratuar | | APK |

| | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Agjencia operon gjatë punës së saj, duke siguruar kështu saktësi dhe efikasitet në komunikimin zyrtar | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 1.6 | Hartimi dhe miratimi i një manuali të brendshëm për trajtimin e rasteve të sinjalizimit të jashtëm | Hartimi i një dokumenti të tillë do të mundësonte standardizimin e procedurave nga pranimi deri në përfundim të rasteve | DS/ DPSMN | | | | | | | | | | | | | | Manuali i hartuar dhe i miratuar | 2000 | APK OSCE? |
| 1.7 | Rishikimi i akteve nënligjore në fuqi | Agjencia bën rishikimin e akteve nënligjore në fuqi, me qëllim të plotësimit dhe përshtatjes me nevojat aktuale të punës | Zyra e Drejtorit/ DPSMN/ dhe Grupi Punues | | | | | | | | | | | | | K1, K2, K3, K4 | 1. Numri i akteve nënligjore të rishikuara<br>2.Aktet nënligjore të plotësuara/miratuara | | APK |

## OBJEKTIVA 2. FUQIZIMI, KOORDINIMI DHE NGRITJA E KAPACITETEVE PROFESIONALE TË AGJENCISË SIPAS MANDATIT LIGJOR

Me fuqizimin dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale të Agjencisë, synohet që të sigurohet përmbushja efektive e mandatit të Agjencisë. Kjo përfshin zhvillimin e aftësive, njohurive dhe burimeve në përputhje me nevojat dhe qëllimet e institucionit, duke siguruar që me ngritjen e kapaciteteve profesionale përmbushet plotësisht mandati dhe fushë-veprimtaria e Agjencisë konform kornizës ligjore në fuqi.

| **2** | **FUQIZIMI, KOORDINIMI DHE NGRITJA E KAPACITETEVE PROFESIONALE TË AGJENCISË SIPAS MANDATIT LIGJOR** | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. | Aktiviteti | Përshkrimi i aktivitetit | Njësia përgjegjëse | Afati Kohor | | | | | | | | | | | | Raportimi | Treguesit e performancës | Vlerësimi i resurseve | |
| | | | | I | II | III | IV | V | VI | VII | VIII | IX | X | XI | XII | | | Kosto | Burimi |
| 2.1 | Hartimi i planeve individuale të punës për gjithë stafin e APK-së | Sipas Rregullores nr. 26/2024 për vlerësimin e rezultateve të punës hartohen planet individuale të punës | NMBNJ | | | | | | | | | | | | | K1 | Hartimi i planeve të punës dhe vlerësimet | Pa kosto shtesë | APK |

| | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 2.2 | Vlerësimi i performancës së Zyrtarëve | Vlerësimi i performancës është një proces i vazhdueshëm, i cili synon përmirësimin e performancës në punë, me qëllim të ngritjes profesionale të zyrtarëve përgjatë kryerjes së detyrave dhe përgjegjësive të tyre | ZD/ Departamentet/Divizionet NMBNJ | | | | | | | | | | | | | K1 , K2 | Raportet individuale të vlerësimit | Pa kosto shtesë | APK |
| 2.3 | Aktivitete rekreative për ngritje të mirëqenies dhe motivimit të stafit të APK-së | Organizimi i aktiviteteve rekreative për stafin e APK-së, ka për qëllim rritjen e mirëqenies, motivimit të punonjësve, si dhe forcimin e bashkëpunimit dhe frymës së ekipit brenda institucionit | ZD/ NMBNJ/ DASHP | | | | | | | | | | | | | K1, K2, K3, K4 | 1.Numri i aktiviteteve të zhvilluara<br>2.Numri i pjesëmarrësve | | Buxheti i APK-së |
| 2.4 | Hartimi dhe Zbatimi i Planit Vjetor të Trajnimeve | Përmes planifikimit dhe hartimit të planit vjetor të trajnimeve synohet ngritja e kapaciteteve profesionale të zyrtarëve të Agjencisë, përmes trajnimeve të strukturuara dhe të përshtatura sipas nevojave institucionale<br>. | ZD/ NMBNJ/ DASHP | | | | | | | | | | | | | K1, K2, K3, K4 | 1. Plani i trajnimeve i miratuar<br>2. Numri i trajnimeve të mbajtura | | Buxheti i APK-së, AD, IKAP, donatorë |
| 2.5 | Trajnim i specializuar lidhur me procedurat e hetimit sipas fushëveprimit të Agjencisë | Agjencia synon ngritjen e kapaciteteve profesionale të hetimeve të avancuara, me qëllim të ngritjes së cilësisë gjatë përgatitjes së raporteve, informatave, kallëzimeve penale sipas standardeve më të larta ndërkombëtare dhe evropiane | ZD/ NMBNJ/ Departamentet/Divizionet | | | | | | | | | | | | | K1, K2, K3, K4 | 1. Numri i trajnimeve të planifikuara<br>2. Numri i trajnimeve të mbajtura | | APK<br>AD<br>OSCE |

## OBJEKTIVA 3. AVANCIMI I SISTEMEVE ELEKTRONIKE TË AGJENCISË DHE DIGJITALIZIMI I PROCESEVE DHE TË DHËNAVE

Agjencia synon që ta vazhdoj trendin pozitiv të avancimit të sistemeve elektronike dhe infrastrukturës së teknologjisë informative. Gjatë vitit 2026, Agjencia do të vazhdoj me avancime në infrastrukturë elektronike, digjitalizim të dokumenteve të arkivuara, zhvillimin e softuerit për protokoll elektronik, dhe rritjen e sigurisë së të dhënave.

| **3** | **AVANCIMI I SISTEMEVE ELEKTRONIKE TË AGJENCISË DHE DIGJITALIZIMI I PROCESEVE DHE TË DHËNAVE** | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. | Aktiviteti | Përshkrimi i aktivitetit | Njësia përgjegjëse | Afati Kohor | | | | | | | | | | | | Raportimi | Treguesit e performancës | Vlerësimi i resurseve | |
| | | | | I | II | III | IV | V | VI | VII | VIII | IX | X | XI | XII | | | Kosto | Burimi |
| 3.1 | Furnizimi me pajisje të teknologjisë informative | Inicimi i projektit, hartimi i specifikave teknike, zhvillimi i procedurave, pranimi i pajisjeve të TI-se, instalimi dhe konfigurimi i pajisjeve të TI-së | Divizioni për E-Shërbime dhe Sisteme | | | | | | | | | | | | | K2, K3, K4 | 1.Inicimi i projektit,<br>2.Hartimi i specifikave teknike<br>3.Zhvillimi i procedurave<br>4.Implementimi | 15000 | APK |
| 3.2 | Digjitalizimi i arkivës fizike të Agjencisë | Organizimi strukturor i dokumenteve digjitale dhe transformimi i tyre nga hard-copy ne elektronike për vitet 2007-2025 përmes procesit të skanimit. Këtu hyjnë dokumentet e arkivuara të Deklarimit dhe verifikimit të pasurisë, Konfliktit të Interesit, Hetimeve, etj. | ZD Divizioni për E-Shërbime dhe Sisteme | | | | | | | | | | | | | K1, K2 | 1.Krijimi i strukturës organizative për ruajtjen e dokumenteve elektronike<br>2.Skanimi dhe ruajtja e tyre<br>3.Qasja sipas niveleve dhe roleve | | APK |
| 3.3 | Ri-zhvillimi dhe avancimi i rrjetit kompjuterik të Agjencisë | Zhvillimi i projektit për zhvillimin dhe avancimin e rrjetit kompjuterik në tërë objektin e Agjencisë | Divizioni për E-Shërbime dhe Sisteme | | | | | | | | | | | | | K2, K3, K4 | 1.Dizajnimi i infrastrukturës,<br>2.Hartimi i specifikave teknike<br>3.Inicimi i projektit<br>4.Zhvillimi i procedurave<br>5.Implementimi | 28000 | APK |
| 3.4 | Digjitalizimi i protokollit | Zhvillimi i një softueri për digjitalizim të librit të protokollit të Agjencisë | Divizioni për E-Shërbime dhe Sisteme | | | | | | | | | | | | | K1, K2, K3, K4 | 1.Përpilimi i specifikave teknike<br>2.Zhvillimi<br>3.Implementimi | | Donator ? |

| | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 3.5 | Ngritja e kapaciteteve harduerike në qendrën e të dhënave të Agjencisë dhe furnizimi me UPS | Për rritjen e kapacitetit dhe sigurisë së të dhënave të Agjencisë dhe sigurimin e stabilitetit energjetik në DC | Divizioni për E-Shërbime dhe Sisteme | | | | | | | | | | | | | K1, K2, K3, K4 | 1.Specifikat teknike<br>2.Furnizimi<br>3.Implementimi | 65000 | Donator ? |
| 3.6 | Zhvillimi i aplikacionit mobil | Zhvillimi i një aplikacioni mobil për të gjitha modulet e platformës "raporto korrupsioni", me qëllim të lehtësimit të raportimit të rasteve nga qytetarët | Divizioni për E-Shërbime dhe Sisteme | | | | | | | | | | | | | K1, K2, K3, K4 | 1.Specifikat teknike<br>2.Procedura<br>3.Zhvillim<br>4.Implementim | 20000 | APK |
| 3.7 | Analizimi dhe Vlerësimi i sistemeve të APK-së për aplikimin e AI-së | Realizimi i një analize të sistemeve DMS, DMSA-CMS, dhe Raporto Korrupsionin. Vlerësimi i të dhënave, strukturës dhe proceseve për të identifikuar pikat kyçe në të cilat mund të aplikohet Inteligjenca Artificiale dhe vënien në funksion të AI asistentit | Divizioni për E-Shërbime dhe Sisteme | | | | | | | | | | | | | K1 | 1. Raporti Analitik me rekomandime konkrete<br>2. Numri i Proceseve të identifikuara për automatizim dhe aplikim të AI-së<br>3. Vizitë studimore në vende e BE-së, që kanë të realizuar punë të ngjashme | | APK Donator |

## OBJEKTIVA 4. AVANCIMI I KOMUNIKIMIT ME PARTNERË DHE AKTERË TË JASHTËM, SI DHE RRITJA E AKTIVITETEVE VETDIJESUESE PER PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT

Agjencia po ashtu synon të avancojë komunikimin dhe të thellojë ndërgjegjësimin e zyrtarëve publik dhe qytetarëve për vlerat e integritetit, transparencës, llogaridhënies dhe kundër-korrupsionit, duke përdorur një qasje të gjerë edukative dhe bashkëpunime me partnerë të jashtëm. Aktivitetet kryesore janë të strukturuara për të përmirësuar transparencën dhe për të fuqizuar kapacitetet e institucioneve publike dhe komuniteteve, përfshirë nxënësit, studentët, zyrtarët publik dhe organizatat joqeveritare.

## 4 AVANCIMI I KOMUNIKIMIT ME PARTNERË DHE AKTERË TË JASHTËM SI DHE RRITJA E AKTIVITETEVE VETDIJESUESE PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT

| Nr. | Aktiviteti | Përshkrimi i aktivitetit | Njësia përgjegjëse | Afati Kohor | | | | | | | | | | | | Raportimi | Treguesit e performancës | Vlerësimi i resurseve | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | I | II | III | IV | V | VI | VII | VIII | IX | X | XI | XII | | | Kosto | Burimi |
| 4.1 | Organizimi i Takimeve vetëdijësuese me nxënës të shkollave të mesme dhe studentë në fushën e drejtësisë, shkencave politike dhe administratë publike | Takime informuese në shkolla të mesme, në universitete publike dhe private, me qëllim të ngritjes së vetëdijes tek të rinjtë për parandalimin e korrupsionit dhe rëndësinë e integritetit | ZD/Komunikimi /Departamentet/Divizionet | | | | | | | | | | | | | K1, K2, K3, K4 | 1.Numri i nxënësve të informuar<br>2.Numri i studentëve të informuar<br>3. Numri i takimeve të realizuara për nxënës<br>4. Numri i takimeve të realizuara për studentë | 4000 EUR materiale | APK/Donator/Komuna/Universitete Publike dhe Private |
| 4.2 | Organizimi i Fushatave në Media Sociale për Parandalimin e Korrupsionit | Fushatë mediatike për informimin e publikut mbi masat kundër korrupsion dhe për të ndarë rastet e suksesit në parandalimin e korrupsionit | ZD/Komunikimi /Departamentet/Divizionet | | | | | | | | | | | | | K1, K2, K3, K4 | 1.Shkalla e përfshirjes në media sociale<br>2.Numri i ndjekësve të rinj në rrjete | 2000 EUR | APK |
| 4.3 | Publikimi i Materialeve Edukative për Integritetin dhe kundër-korrupsionin | Përgatitja dhe shpërndarja e broshurave dhe materialeve digjitale për publikun, duke përfshirë edhe informacione për të rinjtë | ZD/Komunikimi | | | | | | | | | | | | | K2, K4 | 1.Numri i materialeve të shpërndara<br>2.Numri i institucioneve që marrin materialet | 500 EUR | APK |
| 4.4 | Dëgjim publik me OJQ-të dhe publikun, për prezantimin e draft raportit vjetor të performancës së APK-së | Agjencia organizon dëgjim publik me përfaqësues të OJQ-ve dhe publikun, për prezantimin e draft raportin e performancës për vitin paraparak. Agjencia pranon komente dhe sugjerime të cilat i shqyrton gjatë procesit të finalizimit të raportit | ZD/Komunikimi | | | | | | | | | | | | | K3 | 1.Numri i pjesëmarrësve në dëgjim publik<br>2.Numri i komenteve dhe sugjerimeve të pranuara | 2000 EUR | Buxheti i APK-së |
| 4.5 | Shënimi i 20 vjetorit të Agjencisë | Agjencia organizon dhe shënon 20 vjetorin e themelimit të saj përmes aktiviteteve të ndryshme të vetëdijesimit, me qëllim të prezantimit të punës dhe rolit të Agjencisë | ZD/Komunikimi/Departamentet /Divizionet | | | | | | | | | | | | | K3 | 1.Numri i aktiviteteve të planifikuara<br>2.Numri i aktiviteteve të realizuara | 5000 EUR | Buxheti i APK-së |

| | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4.6 | Podcast/Videocast mbi Integritetin dhe Transparencën | Krijimi dhe publikimi i një podcast-i/videocast-i të APK-së, ku zyrtarë të Agjencisë, ekspertë të fushës, studentë, përfaqësues të institucioneve publike dhe aktorë të shoqërisë civile diskutojnë mbi temat që lidhen me integritetin, transparencën dhe parandalimin e korrupsionit. Kjo platformë mund të shërbejë si mjet edukativ dhe informues për publikun, duke promovuar praktikat e mira të qeverisjes së mirë, politikat e APK-së dhe shembuj konkretë të integritetit institucional | ZD/Komunikimi /Dep. të APK | | | | | | | | | | | | | K1, K2, K3 K4 | 1.Numri i episodeve (podcast/videocast) të prodhuara dhe të publikuara;<br>2.Niveli i angazhimit të publikut (pëlqime, komente, ndarje, pyetje gjatë episodeve) | 2000 EUR | APK/Media |
| 4.7 | Prodhim dhe transmetim i materialeve interaktive online | Prodhimi i materialeve të shkurtra audiovizuale dhe transmetimi i tyre në platformat e rrjeteve sociale që ndiqen kryesisht nga të rinjtë. Materialet përgatiten dhe përshtaten nga zyrtarët e APK, në përputhje me temat prioritare të Agjencisë, me qëllim komunikimin efektiv të mesazheve lidhur me: integritetin, konfliktin e interesit, deklarimin e pasurisë dhe të dhuratave, si dhe raportimin e korrupsionit - sinjalizimin | ZD/Komunikimi/Dep. të APK-së | | | | | | | | | | | | | K1, K2, K3, K4 | 1.Numri i materialeve të transmetuara<br>2.Numri i shikimeve nga pjesëmarrësit<br>3.Numri i ndërveprimeve të qytetarëve | 2000 EUR | APK/Media |
